



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

01 Nr. 221-45905/19

Date 08.11.2019

KONTRATA PUBLIKE KONIZ nr. 101-2019

, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZ

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; Nr Bisnesi 07000032, Nr Fiskal 600219366 , qe perfaqesohet nga Menaxheri i Prokurimit z. Abaz Foniqi

Dhe

"MIRUSHA COMPANY- shpk " ME SELI NE KLINE & "ARBOTEC -SHPK Nga PRISHTINA , qe ne baze te marrëveshjes per krijim te grupit bartës i kontratës eshte MIRUSHA COMPNAY NGA KLINA , ne tekstin e metejme kontraktuesei me numer biznesi 70476040, numer fiskal 600048137, me perfaqesues z. MENTOR SELIMI .

ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE

me numër identifikues: 634-19-7193-2-2-1/INT.634-19-088-221

Neni 1 **Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e SHERBIMEVE në vijim:

1.2. SHERBIMET JANE TE NDARA NE ZONA QE PERCAKTOJNE EDHE RRUGET QE JANE PER MIREMBAJTJE DHE PERKUJDESJE GJATE TERE SEZONES SE DIMRIT



LOT 1 - ZONA PARE E RRUGEVE .

1. Grebnik, 2. Qupevw e Ultë, 3. Qupevë e Lartë, 4. Volljakë, 5. Dush, 6. Sferkë, 7. Perqevë, 8. Gllarevë, 9. Rixhevë, 11. Zaberqje, 12. Cerovik, 13. Qabiq, 14. Dobërdol, 15. Ujmir, 16. Siqevë, 17. Shtaricë, 18. Dush i Vogël, 19. Jashanicë, 20. Pograxhë, 21. Kërrnicë, 22. Klinavc.

LOT 2 - ZONA DYTE E RRUGEVE,

1. Klinë, 2. Lagja Arbëria, 3. Deiq, 4. Zajm, 5. Grabanicë, 6. Dollovë, 7. Rastoka, 8. Qeskovë, 9. Këpuz, 10. Bokshiq, 11. Dugajevë, 12. Poterq i Epërm, 13. Poterq i Poshtëm, 14. Drënoc, 15. Videj, 16. Jagodë, 17. Dresnik, 18. Dollc.

LOT 3- ZONA E TRETE E RRUGEVE.

1. Gjurgjevik i Vogël, 2. Shtupel, 3. Grapc, 4. Binxhë, 5. Ranoc, 6. Leskoc, 7. Zllakuqan, 8. Krushevë e Madhe, 9. Nagllavë, 10. Budisalc, 11. Stupë, 12. Rudicë, 13. Berkovë, 14. Potaqan, 15. Radulloc, 16. Krushevë e Vogël.

1.3. Vlera Totale e Kontrates me TVSH dhe taksa tjera është sipas planifikimit deri 120.000.00€ (Njëqindnjëzetë euro)

Zona pare – deri ne 40.000.00 euro , Zona Dyte deri ne 40.000.00 euro dhe Zona trtet deri 40.000.00 €

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë i përditshëm sipas përshkrimit të detyrave nga neni 1 i kësaj kontrate është nga dita e nënshkrimit deri ne përfundimin sezonit dimëror perketesisht dates 30.05.2020

Vendi i kryerjes se shërbimeve është sipas nevojave ne baze te kushteve te krijuara nga reshjet e bores dhe Kërkesave nga Njesia kërkuese .

Rrugët dhe trotuarët janë të përcaktuara nga Zonat që janë të dhëna ne nenin 1.2.

Neni 3 Çmimi

3.1. Çmimet janë për njësi .Dhe do të jenë baze për Llogaritje të shërbimeve sipas Nevojave dhe kryerjes se shërbieve ne terren.

Zona pare .

Nr.	Titulli	Çmimi për njësi (me TVSh)	Sasia	Njësia matëse	Totali (me TVSh)
1	furnzim me krip	0.65	1.00	kg	0.65
2	furnzim me rere	5.20	1.00	ton	5.20
3	Pastrim i bores , shperndarje e kripes dhe reres ,Ore efektive te borepastrueeve (kamionit ne rruge dhe trotuare	27.51	1.00	ore pune	27.51

Zona dyte .

Nr.	Titulli	Çmimi për njësi (me TVSh)	Sasia	Njësia matëse	Totali (me TVSh)
1	furnzim me krip	0.65	1.00	kg	0.65
2	furnzim me rere	5.20	1.00	ton	5.20
3	Pastrim i bores , shperndarje e kripes dhe reres ,Ore efektive te borepastrueeve (kamionit ne rruge dhe trotuare	27.51	1.00	ore pune	27.51

Zona trete .

Nr.	Titulli	Çmimi për njësi (me TVSh)	Sasia	Njësia matëse	Totali (me TVSh)
1	furnzim me krip	0.65	1.00	kg	0.65
2	furnzim me rere	5.20	1.00	ton	5.20
3	Pastrim i bores , shperndarje e kripes dhe reres ,Ore efektive te borepastrueeve (kamionit ne rruge dhe trotuare	27.51	1.00	ore pune	27.51

3.2.Mirembajtje e rrugeve ne sezonin dimrore –

Pastrim te bores, shkrirje e akullit me krip , pastrim i trotuareve , shpernarje e kripes dhe aktivitete qe do te mundesojne qarkullim te lire te automjeteve pa pengesa nga bora, ngricat etj.

Pershkrimi i Sherbimeve qe duhet kryer ne baze te kësaj kontrate

3.3. POZICIONET PËR MIRËMBAJTJEN DIMËRORE TË RRUGËVE DHE TROTUAREVE NË RRUGET E KLINËS NE SEZONIN DIMROR 2019-2020**Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve:**

Aktivitetet e parapara për realizimin e punimeve në “Mirëmbajtjen dimërore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës për periudhat 15.11.2019-15.05.2020; janë si në vijim:

a) Hartimi i Planit Operativ

b) Aktivitetet e parapara gjatë kohës së reshjeve dhe ngricave;

- c) Hedhja e kripës të kombinuar me rërë;
- d) Hedhja e rërës;
- e) Aktivitetet e parapara gjatë kohës pa reshje të borës dhe ngricave;
- f) Furnizimi me rërë dhe kripë.

Aktivitetet e parapara duhet të ekzekutohen në përpikëri, në funksion të temperaturave

SPECIFIKIMI I AKTIVITETEVE:

a) Plani Operativ

Në planin mbi organizimin e punës parashihet të prezantohet mënyra e organizimit të punës për largimin e borës dhe akullit, hedhjen e kripës dhe rërës, mbledhjes së mbeturinave, fshirjes së rrugëve dhe trotuareve. Në këtë planë parashihet të prezantohen pajisjet të cilat do të angazhohen si dhe punëtorët që do të angazhohen për kryerjen sa më efikase të punës. Ky plan duhet të përfshijë të gjitha rrugët që do të trajtohen duke marrë parasysh kohën e nevojshme për ekzekutimin dhe duhet të trajtojë tri gjendje:

1. Kur ka reshje të pandërprera dhe të dendura të borës;
2. Kur kemi reshje normale të borës apo ngrica;
3. Kur nuk kemi reshje dhe temperaturat janë të përshtatshme për Pastrim pa presion .

Plani duhet të paraqitet në formë tabelore ku prezantohet koha e nevojshme dhe lloji i mekanizmit që do të shfrytëzohet për secilën rrugë.

b) Aktivitetet e parapara gjatë kohës së reshjeve dhe ngricave

Pas lidhjes së kontratës OE duhet të ketë të gjitha pajisjet e kërkuara në autopark të OE. Këto pajisje duhet të jenë në gjendje të rregullt dhe të gatshme për punë. Largimi i borës nga sheshet, rruga dhe trotualet duhet të bëhet në funksion të Planit Operativ me parë të aprovuar nga organi mbikëqyrës. Ky pozicion u punës parashihet të kryhet në funksion të kategorisë së rrugës/shesheve.

Në sheshe – **Kategoria A'** gjatë kohës së reshjeve me borë dhe ngricave duhet të kemi mirëmbajtje permanente ku dhe parashihet që numri i pastrimeve gjatë ditë të tërë sipërfaqes.

Në rrugë dhe trotualet të **Kategorisë A** gjatë kohës së reshjeve me borë dhe ngricave duhet të kenë monitorim gjatë tërë kohës dhe të kemi mirëmbajtje permanente

Në rrugë dhe trotualet të **Kategorisë B** gjatë kohës së reshjeve me borë dhe ngricave duhet të kemi mirëmbajtje gjatë tërë kohës dhe të monitorohen pikat e rrezikshme. Parashihet që numri i pastrimeve të arrijë mbi 3 pastrime në ditë të tërë sipërfaqes.

Në rrugë dhe trotualet të **Kategorisë C** gjatë kohës së reshjeve me borë dhe ngricave duhet të kemi mirëmbajtje gjatë tërë kohës dhe të monitorohen pikat e rrezikshme. Parashihet që numri i pastrimeve të arrijë mbi 2 pastrime në ditë të tërë sipërfaqes.

Në rrugë dhe trotualet të **Kategorisë D** gjatë kohës së reshjeve me borë dhe ngricave duhet të kemi mirëmbajtje gjatë tërë kohës dhe të monitorohen pikat e rrezikshme. Parashihet që një pastrime të kryhet në ditë të tërë sipërfaqes.

Për çdo ditë me reshje të borës varësisht nga koha e fillimit të reshjeve fillimi i punës për pastrimin e borës duhet të jetë menjëherë pas fillimit të reshjeve, derisa nëse ato janë të pandërprera largimi i borës dhe akullit duhet të jetë i pandërprerë dhe të gjitha rrugët duhet të jenë të pastruara nga bora dhe akulli para

kohës kur veç fillon fluksi i automjeteve (ora 7 e mëngjesit). Numri i automjeteve të cilat duhet të shfrytëzohen është në përputhje me specifikave teknike të kërkuara në **Specifikat teknike**. Në rast se kompania e kontraktuar nuk e përfill **Planin Operativ** (marrëveshjen) atëherë do të pasohet me ndërprerje të kontratës dhe OE do të shpallet si i papërgjegjshëm. Bora dhe shtresat e akullit të cilat grumbullohen gjatë pastrimit duhet të largohen nga sipërfaqja e rrugës dhe të deponohen në një hapësirë jashtë Qytetit. Bora dhe akulli i mbledhur nga rrugët nuk guxojnë të hedhën në hapësirat e gjelbëruara apo në ndonjë vend tjetër përgjatë rrugës, nëse OE i kontraktuar nuk e përfill këtë gjë dhe gjendet duke hedhur në hapësira publike të lartcekura do të gjëbëhet nga Inspeksioni Komunal dhe njëkohësisht do të pasohet me ndërprerje të kontratës.

Vërejtje: OE është i obliguar të ketë një ekip i cili e monitoron terrenin gjatë gjithë kohës kur temperaturat janë të ulëta dhe pritet reshje apo ngrica. Në rast se monitorimi nuk është i suksesshëm atëherë barra për aksidentet e mundeshe i takon OE i cili operon në këtë pjesë. Pastrimi i rrugëve nga bora dhe akulli duhet të bëhet me makina përkatëse për largimin e borës. Largimi i borës dhe akullit nga rrugët aty ku ka pengesa nga veturat apo diçka tjetër, të bëhet me angazhimin e punëtorëve fizik. Në rast të moslargimit të borës dhe akullit nga rrugët kompanisë do ti minusohet shuma për pastrimin e asaj rruge dhe do ti jepet vërejtje. Në rast kur kompania megjithëse pranon vërejtjen vazhdon mospërfilljen e respektimit të marrëveshjes atëherë kompanisë do ti ndërpritet kontrata dhe do të shpallet si kompani e papërgjegjshme.

Në rast të defekteve me makineri kompania duhet të lajmëroi me shkrim organin mbikëqyrës (përmes email-it) dhe duhet të i specifikoi edhe kohën kur do të rregullohet mekanizmi përkatës. Në rastet kur mekanizmi nuk mund të rregullohet apo kërkon një periudhë më të gjatë se 24orë për rregullim operatori është i obliguar të huazoi apo të blejë një makinë tjetër në të kundërtën do të shpallet i papërgjegjshëm dhe do ti ndërpritet kontrata

c) Hedhja e kripës të kombinuar me rërë

Hedhja e rërës e kombinuar me kripë bëhet në të gjitha rrugët e asfaltuara në mënyrë që të ndihmon në shkrirjen e borës dhe njëkohësisht të mban rrugën më të pastër nga shtresat e borës të cilat nuk mund të largohen me makinat për pastrim të borës. Kombinimi i rërës me kripë bëhet në raport 0.5[m3]kripë/1.0[ton] rërë. Hedhja e përzierjes kripë-rërë duhet të bëhet me makina speciale për hedhje dhe në sasinë e kërkuar me kontratë. Hedhja e kombinimit duhet të bëhet në temperaturat mbi -6°C. Në rast se temperaturat kapin vlera më të ulëta nuk duhet të hidhet kombinimi rërë kripë por të vazhdohet vetëm me pastrim të borës dhe nëse ka nevojë edhe me hedhje të rërës.

d) Hedhja e rërës

Hedhja e rërës të pa-kombinuar me kripë bëhet në të gjitha rrugët dhe trotualet të paasfaltuara në të cilat mund të dëmtohet shtresa qarkulluese si rezultat i prezencës së kripës. Shpërndarja e rërës duhet të bëhet me makina speciale për shpërndarje

e) Aktivitetet e parapara gjatë kohës pa reshje të borës dhe ngricave

Në ditët në të cilat nuk ka reshje bore apo ngrica dhe njëkohësisht janë larguar të gjitha hapësirat e mbuluara me bore apo akull vazhdohet me mbledhjen e mbeturinave dhe pastrimin e rrugëve në përputhje

Kontraktuesi Gjithë here duhet të ketë të siguruar sasi të mjaftueshme të Kripes dhe reres për Intervenime të përditëshme gjatë Validitetit të Kontrtaes .

3.4. Paisjet dhe Lokacioni .

LOTO 1**I. Mjetet e punës:**

Mjetet e Punës		Njësia	Sasia
1.	Automjet për largimin e borës me Mekanizem per Largim te bores nga para automjetit , dhe Makineri per shpërndarje te kripës.	Cope	3 Minimum
2.	Freza dore për largimin e borës në trotuare	Cope	2 Minimum
3.	Ngarkues i madh	Cope	1 Minimum
4.	Ngarkues i vogël	Cope	1 Minimum
5.	Automjet – me paisje per largim te bores ne pjesët me te ngushta na pjesa e parme e automjetit	Cope	1 Minimum
6.	Kamionetë 3.5 t për bartjen e mbeturinave, minimumi.	Copë	1 Minimum
7.	Paisje dore lopata dhe mjete tjera rrethore per pastrim bore ne trotuare vende ku nuk mund te perdoret makineria etje	copë	10 Minimum
8.	Radiolidhje apo mjete tjera rrethore qe te jete ne lidhje Online 24 me A.K	cope	Min 1 ne qender
9.	Lokacioni – Vendqendrimi i Bazes te kompletuar me makinerinë dhe stafin 24 ore Dëshmi qe posedon lokacionin apo Mareveshje e marrjes me qera per shfrytëzim Lokacioni per kete Lot ne baze te Marreveshjes dhe dokumenteve te O.E eshte ne GLLAREVE .	cope	1

LOTO 2**II. Mjetet e punës:**

Mjetet e Punës		Njësia	Sasia
1	Automjet për largimin e borës me Mekanizem per Largim te bores nga para automjetit , dhe Makineri per shpërndarje te kripës.	Cope	3 Minimum
2	Freza dore për largimin e borës në trotuare	Cope	2 Minimum
3	Ngarkues i madh	Cope	1 Minimum
4	Ngarkues i vogël	Cope	1 Minimum
5	Automjet – me paisje per largim te bores ne pjesët me te ngushta na pjesa e parme e automjetit	Cope	1 Minimum
6	Kamionetë 3.5 t për bartjen e mbeturinave, minimumi.	Copë	1 Minimum
7	Paisje dore lopata dhe mjete tjera rrethore per pastrim bore ne trotuare vende ku nuk mund te perdoret makineria etje	copë	10 Minimum
8	Radiolidhje apo mjete tjera rrethore qe te jete ne lidhje Online 24 me A.K	cope	Min 1 ne qender
9	Lokacioni – Vendeqendrimi i Bazes te kompletuar me makinerinë dhe stafin 24 ore Dëshmi qe posedon lokacionin apo Mareveshje e marrjes me qera per shfrytëzim Lokacioni per kete Lot ne baze te Marreveshjes dhe dokumenteve te O.E eshte ne KLINE .	cope	1

LOTO 3**III. Mjetet e punës:**

Mjetet e Punës		Njësia	Sasia
1	Automjet për largimin e borës me Mekanizem per Largim te bores nga para automjetit , dhe Makineri per shpërndarje te kripës.	Cope	3 Minimum
2	Freza dore për largimin e borës në trotuare	Cope	2 Minimum
3	Ngarkues i madh	Cope	1 Minimum
4	Ngarkues i vogël	Cope	1 Minimum
5	Automjet – me paisje per largim te bores ne pjesët me te ngushta na pjesa e parme e automjetit	Cope	1 Minimum
6	Kamionetë 3.5 t për bartjen e mbeturinave, minimumi.	Copë	1 Minimum
7	Paisje dore lopata dhe mjete tjera rrethore per pastrim bore ne trotuare vende ku nuk mund te perdoret makineria etje	copë	10 Minimum
8	Radiolidhje apo mjete tjera rrethore qe te jete ne lidhje Online 24 me A.K	cope	Min 1 ne qender
9	Lokacioni – Vendqendrimi i Bazes te kompletuar me makinerinë dhe stafin 24 ore Dëshmi qe posedon lokacionin apo Mareveshje e marrjes me qera per shfrytëzim Lokacioni per kete Lot eshte ne bae te dokumentev te O.E GJURGJEVIK TE VOGEL	cope	1

3.5 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

3.6 Çmimi i përmendur në Nenin 1.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kryesit të punimeve sipas kontratës publike.

3.7 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike .

3.8 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

3.9.Dhe ate me fature dhe Raport mbi kryerje te puneve , Jo me larg se 30 dite pas pranimit te fatures dhe Raportit .

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3. Pagesat do te ekzekutohen me keste sipas dinamikës së kryerjeve të shërbimeve , me raport nga organi mbikqyres dhe aprovim nga menaxheri i projektit

4.4. . Sipas Situacioneve mbi kryerje te punimeve .

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *puneve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

6.2. Kryesi i puneve do te jete pergjegjes per Demtimet te shkaktuara me dashje apo pa kujdesi ne masen e demit qe do te percaktohet nga zyrtari pergjegjes .

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Ne raste deshtimit apo voneses ne Implementim , O.E ka Obligim per Sherbimet gjate tere kohes kur kërkohet nga A.K.Per pergjegejsit ne trafik nga moskryerja e shërbimeve nga Kontraktues , pergjegjesia eshte e Kryesit te shërbimeve perketesisht O.E .

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, dhe të shikoj furnizimet e bera nese eshte ne masen e cilesive te kerkuara .

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

10.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 5 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

11.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

11.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore _dega Kline në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 12 Komunikimi

12.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë

12.2 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


Neni 13. Menaxhimi i projektit dhe menaxhimi i kontrates .

13.1. Menxhimi i projektit do te behet nga njesia kerkuese –Implementuese Drejtoria Urbanizmit Komuna Kline

13.2 .Menxhimi i Kontrates . Bazuar ne neni 81 te LPP , Menaxhi i kontrtaes me vendim te ZKA do te jete : _____ nga _____

13.3 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët **Shqipe** në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

**Për Autoritetin Kontraktues
KOMUNA KLINE**

Emri:	ABAZ FONIQI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	08.11.2019
Vula:	

**Për Ofruesin e Shërbimeve :
MIRUSHA COMPANY SHPK – KLINE**

Emri:	FIDAN SELIMI
Pozita:	PRONAR
Nënshkrimi:	
Data:	08.11.2019
Vula:	

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 “**Shërbimet**” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 “**Ofrues i shërbimeve**” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rëndë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që bën Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve sigurve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur sigurve të kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontrahohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditëve para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të pëmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospective dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objekteve ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozionet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbushë detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasat ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbylljen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës; (i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës; (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafë të kryejë një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet t'i behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie të pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike komizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shumata nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arrijen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimë në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimin.

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <u>SHERBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENTE</u>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është: <i>10 % vlerës së Plafikuar të kontratës, PERKATESISHTE VLERA 12.000.00 € ME AFATE DERI 30.06.2020</i>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë <i>100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës</i> b) Përgjegjësia e palës së tretë <i>100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës</i> c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve <i>100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës</i> d) Përgjegjësia profesionale <i>100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës</i> Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve <i>100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës</i>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është gjatë kohës së Validitetit të Kontratës.
Afati i Implementimit	17.2	Plani i plementimit të projektit NE Baze të Situatave të krijuara nga Reshjet e bores , perkatesisht ne tere sezonin dimëror 2019-2020 .
Mos realizimii apo sanksionet	17.3	Sanksionet dhe penalltit per moskryerje te shërbimeve me denime dhe mospages ne masen e shkatimit te demeve per mos kryerje ne nivel te shërbimeve .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Do te përpiqet qe me pajtueshmëri te dy paleve te zgjidhen problemet .
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore Peje – Dega Kline në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

PJESA IV E KONTRATËS: MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT

[Llogon e institucionit financiar i cili siguron garancionin]

Për: KUVENDI KOMUNAL I KLINËS

(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: NPT MIRUSHA SHPK - KLINE

(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: MIREMBAJTJA DIMEROR E RRUGEVE

Numri i prokurimit: 634-19-7193-2-2-1/INT. 634-19-088-221

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **12.000.00 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: 12.000.00 € siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri me 30.06.2020

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i institucionit financiar

Adresa

PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Name	"Mirusha Company" sh.p.k
Emri	"Mirusha Company" sh.p.k
Adresa	Rruga Abedin Rexha pn
Qyteti	Klinë
Kodi Postar	32000
Kontakti	Mentor Selimi
Telefoni	045/333-332
Faxi	-
E-mail	Mirusha.transport@live.com
Numri i llogarisë	330037540

BANKA	
Name	NLB BANKA
Emri	NLB BANKA
Adresa	Rruga Abedin Rexha nr.4
Qyteti	Klinë
Kodi Postar	32000
Shteti	Kosovë
Numri i Bankës	1706-0010-1126-5025
IBAN (obligator)	
BIC (obligator)	

SHËNIME:

VULA E BANKËS
SHËNIMET
MBARTËSITË TË BANKËS
(të dyja të obligueshme)
 NLB Banka Ekspozitura Klinë - Shifra 729

DATA E SHËNIMIT
MBARTËSITË TË LLOGARISË
(obligueshme)
17.10.2017 



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TE BIZNESIT NE KOSOVE
AGENCIJA ZA REGISTROVANJE BIZNISA
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810317067

Numer Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

MIRUSHA COMPANY SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Adresa:
Adresa:
Address:

Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Društva sa ograničenom odgovornošću
Limited Liabilities Companies

, Abedin Rexha
Klinë

14/02/2008

15/04/2019

Data / Date / Datum

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10019204



Nënshkrimi / Signature / Potpis



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESIT NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJU BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

**CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION**

810533879

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

Arbotec SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business



Emri tregtar / Trgovacko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Društva sa ograničenom odgovornošću
Limited Liabilities Companies

Adresa:
Adresa:
Address:


Bulevardi Bill Clinton nr.76
Prishtinë

Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

15/08/2007


10/04/2019

Data / Date / Datum



Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: **10017622**



**MIRUSHA
COMPANY**

Numri i biznesit: 70476040
Numri fiskal : 600048137
Numri Unik Identifikues: 810317067
Adresa: Klinë, Rr. Abedin Rexha
Tel: +383-45 333 332

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E MENAXHERIT TË PROJEKTIT

"Mirusha Company" sh.p.k ka marrë vendim për caktimin e Menaxherit të projektit për projektin "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale me asfalt në Territorin e Komunës së Klinës ; LOT 1 - ZONA PARE E RRUGEVE" me nr.prokurimi : 634-19-7193-2-2-1 dhe nr. të brendshëm : 634-19-096-221

Menaxher i projektit caktohet **Kadri Berisha -Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë- Drejtimi konstruktiv.**

Menaxheri i projektit do të mbikëqyrë punimet gjatë gjitha fazave të implementimit të projektit të sipërpërmendur dhe njëkohësisht është përgjegjës për kontaktim me Autoritetin Kontraktues.

"Mirusha Company" sh.p.k



Nr.Unik : 810317067

Rr." Abedin Rexha" p.n. Klinë

DEKLARATË

Duke qenë se "Mirusha Company" shpk" shpk po merr pjesë në tenderin:

"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale me asfalt ne Territorin e Komunës se Klinës:
LOT 1 - ZONA PARE E RRUGEVE .LOT 2 -ZONA DYTE E RRUGEVE, LOT 3-
ZONA E TRETE E RRUGEVE." me nr. prokurimi 634-19-7193-2-2-I dhe nr. të brendshëm
634-19-096-221

Deklarojmë se të gjithë punëtorët e prezentuar janë punëtor të rregullt në kompani
dhe zotohemi se do të ripërtrijmë kontratat e prezentuara dhe do të vazhdoen
deri në përfundim të projektit.

"MIRUSHA COMPANY" SH.P.K

Mentor Selimi

Menaxher



Nr.Unik : B10317067

Rr." Abëdin Rexha" p.n. Klinë

DEKLARATË

Duke qenë se "Mirusha Company" shpk" shpk po merr pjesë në tenderin:

"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale me asfalt në Territorin e Komunës së Klinës :
**LOT 1 - ZONA PARE E RRUGEVE .LOT 2 -ZONA DYTE E RRUGEVE, LOT 3-
ZONA E TRETE E RRUGEVE."** me nr. prokurimi 634-19-7193-2-2-I dhe nr. të brendshëm
634-19-096-221

Me anë të marrëveshjes për qiradhënie (dhënie në shfrytëzim) të pronës , të lidhur
në mes të "Mirusha Company" sh.p.k dhe me zt.Bujar Morina ne deklarojmë se
jemi të gatshëm të montojmë bazën mobile për furnizim dhe nevoja të LOT 1 në
projektin e lartëcekur

Baza do të vendoset në pronën e zt.Bujar Morina e cila pronë është në përputhje
me nevojat dhe kërkesat për LOT 1.

"MIRUSHA COMPANY" SH.P.K

Mentor Selimi

Menaxher



Nr.Unik : 810317067
Rr." Abedin Rexha" p.n. Klinë

DEKLARATË

Duke qenë se "Mirusha Company" shpk" shpk po merr pjesë në tenderin:

"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale me asfalt ne Territorin e Komunës se Klinës :
**LOT 1 - ZONA PARE E RRUGEVE .LOT 2 -ZONA DYTE E RRUGEVE, LOT 3-
ZONA E TRETE E RRUGEVE."** me nr. prokurimi 634-19-7193-2-2-I dhe nr. të brendshëm
634-19-096-221

Deklarojmë se posedojmë prona (Bashkangjitur fletën poseduse) të cilat
përmbushin kërkesat e LOT 2 dhe ku do të vendosim bazën mobile për furnizim
dhe nevoja per kryerje të punimeve.

"MIRUSHA COMPANY" SH.P.K.

Mentor Selimi

Menaxher



Nr.Unik : 810317067
Rr." Abedin Rexha" p.n. Klinë

DEKLARATË

Duke qenë se "Mirusha Company" shpk" shpk po merr pjesë në tenderin:

"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale me asfalt ne Territorin e Komunës se Klinës :
**LOT 1 - ZONA PARE E RRUGEVE .LOT 2 -ZONA DYTË E RRUGEVE, LOT 3-
ZONA E TRETE E RRUGEVE."** me nr. prokurimi 634-19-7193-2-2-1 dhe nr. të brendshëm
634-19-096-221

Me anë të marrëveshjes së qiradhënies (dhënie në shfrytëzim) të pronës të lidhur në
mes të "Mirusha Company" sh.p.k dhe me zt.Ali Elezaj ne deklarojmë se jemi të
gatshëm të montojmë bazën mobile për furnizim dhe nevoja të LOT 3 në projektin
e lartëcekur

Baza do të vendoset në pronën e zt.Ali Elezaj e cila pronë është në përputhje me
nevojat dhe kërkesat për LOT 3.

"MIRUSHA COMPANY" SH.P.K

Mentor Selimi

Menaxher





Sigurimi i Ekzekutimit

Nr Policës
Policë Nr.

1009696

Kontraktuesi:	MIRUSHA COMPANY SH.P.K & ARBOTEC SH.P.K				
Përfaqësuar nga:	FIDAN SELIMI, MENTOR SELIMI, SELMAN SELIMI				
Adresa:	Rr. ABEDIN REGJA				
Nr. i Biznesit:	70476040				
Garantuesi:	K.S. Kosova e Re SH.A				
Banka e Garantuesit:	BEK - Banka Ekonomike				
Përfituesi:	KUVENDI KOMUNAL I KLINËS				
Adresa e Përfituesit:	KLINË				
Shuma e Sigurimit:	12,000.00				
Numri i Dokumentit:	634-19-7193-2-2-1				
Titulli i Kontratës:	Mirembajtja dimerore e rrugëve.				
Data e Fillimit:	07/11/2019	Data e Mbarimit:	30/06/2020		
Primi:	168.00	TVSH:	30.24	Totali:	198.24
Mënyra e pagesës:	Transfer Bankar	Nr Llogarie:	1401000000597893		
Data e Lëshimit:	07/11/2019 00:00:00				

Lënda e garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

1. Mbështetur në këtë Policë - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merr përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë policë.

2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.

3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit / Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi te Siguruesi / Garantuesi).


4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.

5. Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) si dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng).

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit pajtohem që K.S. Kosova e Re të i ruaj të dhënat e mia personale/biznesit, të cilat do të përdoren nga kompania për qëllime statistikore, hulumtime dhe raportime në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe për trajtimin e dëmeve. Gjithsesi kuptohet se unë i siguroj me vullnet të lire, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit dhe kame lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit të

Burim Gashi B.I

Zyrtari i Shitjes





Kompania e Sigurimeve sh.a. - Insurance Company s.a.

KOSOVA e RE

POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCIONIT
GUARANTEE INSURANCE POLICY

Nr. Serik 004225

Deklarat e Garancionit

Nr Policës
Policy No:

1009696

Sigurimi i Ekzekutimit

Për: KUVENDI KOMUNAL I KLINËS
(Autoriteti kontraktues)
Në emër të: MIRUSHA COMPANY SH.P.K & ARBOTEK SH.P.K
(Operatori ekonomik)
Titulli i aktivitetit Mirembajtja dimerore e rrugëve.

Nr i Prokurimit: 634-19-7193-2-2-1

Garancion me kërkesë të pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri e garancionit duke iu referuar dosjes, me numër të prokurimit/dosjes të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurimin e garancionit në shumën e saktësuar të specifikuar në dosje;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë sigurim:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total e shuma e sigurimit, zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- 1 Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë;
- 2 Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar deri ne shumën e sigurimit, siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Shuma e Sigurimit €: 12,000.00

Ky sigurim vlen deri sh.a. 30/06/2020

Nënshkrimi dhe vula e Garancionit

Data e lëshimit:

07/11/2019





PLANI PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS

Sipas Nenit 81.2 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042

Data e përgatitjes së PMK¹ 08.11.2019

Përgatitur nga: **vendos emrin dhe mbiemrin e Menaxherit të Projektit të AK-**
-DREJTOR I DREJTORISE SHERBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENTE - KLINE

Numri i Prokurimit	634-19-7193-221/634-19-088-221	
Titulli i Kontratës	MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE	
Punë/Shërbime/Furnizime	Viti Buxhetor	Emri dhe mbiemri i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit
PUNE	2019	ABAZ FONIQI

Ngjarjet/Rezultatet e Kontratës	DETAJET E IMPLEMENTIMIT <i>Afatet -KORNIZ SEZONI DIMEROR 2019-2020</i> <i>VLERA. PLANIFIKUAR 120.000.00 €</i>
Pjesët nën 'Detajet e Implementimit' në <i>italike</i> duhet të kompletohen dhe të bien dakord në mesë të palëve të kontratës para inicimit të implementimit të kontratës. PMK duhet të përtërihet gjatë implementimit të kontratës. Vendos Nuk Aplikohet për ato që nuk janë relevante	
I. Fillimi/ Mobilizimi i Kontratës	
Njoftimi për fillimin e punës/shërbimeve/furnizimit të mallrave	
Afati i përmbushjes	PLANI IMPLAEMTIMIT -SEZONI DIMEROR 2019-2020
Pranimi i garancisë së performancës dhe lirimi i sigurimit të tenderit	
Pranimi i garancisë së pagesës në avans, nëse është e aplikueshme	SKA AVANS

¹ Plan i Menaxhimit të Kontratës është dokument i gjallë i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. Plan i Menaxhimit të Kontratës është i hapur për monitorim të KRPP-së gjatë implementimit të kontratës dhe të gjitha auditimeve tjera të kryera nga organet shtetërore. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Pagesa e avansit , nëse është e aplikueshme	SKA
Dorëzimet e para Shërbimet: raporti fillestarë Punët: instalimi i parë	
Shuma e dëmeve të likuiduara përfshirë kufizimin e dëmeve të likuiduara	
Periudha e përgjegjësisë për defekte	
II. Progresi i Kontratës	
Dorëzimet e Mëtitjeshme Shërbimet: raportet e progresit etj. Punët: instalimi i dytë etj.	<i>Kontraktuesit në fazat e progresit të implementimit të kontratës]</i>
Bisedimet e Rregullta, nëse është e aplikueshme	<i>Vendos këtu planin e afatit kohorë kur do të ndodhin takime të parapara në vazhdimësi</i>
Inspektimi i punëtorive, materialeve dhe vendeve të prodhimit	<i>Specifikoni procesin e inspektimeve, të rregullta/ad hoc, dhe detajet e hulumtimeve të tilla.</i>
Pagesat e përkohshme apo në faza, nëse është e aplikueshme	<i>Specifikoni modalitetet e pagesave (në detaje) gjatë fazave të performimit të kontratës Pagesat konform kontrates pas pranimi te furnizimeve me fature dhe raport</i>
Reduktimi i garancive, nëse është e aplikueshme	<i>Ska avans</i>
III. Përmbyllja e Kontratës	
Dorëzimet Finale Shërbimet: Raporti Final Punët: Përfundimi i Punëve	
Pranimi/ dorëzimi	
Pagesa e Fundit	
Fondet e mbajtura	
Skadimi i garancionit/periudha e përgjegjësisë	
Lirimi i garancisë	

Finalizimi i Planit të Menaxhimit të Kontratës²:

**Në emër të Autoritetit Kontraktues ; KK KLINE –DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE
DHE EMERGJENTE**

Nënshkrimi: _____

Emri: IBER ELEZAJ

Pozita: DREJTOR

Data: _____

Në emër të [Kontraktuesit/Ofruesit të Shërbimeve – MIRUSHA COMPANY - KLINE

Emri: MENTOR SELIMI

Nënshkrimi: _____

Mentor Selimi



Pozita: _____

DREJTOR

Data: _____

08.11.2019

MENAXHER I KONTRATE nga O.E, Z. KADRI BERISHA.

² Të nënshkruhet nga dy Menaxherët e Projektit